



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES KOMEMORATIVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 27 KORRIK 2018**

**SA KOMEMORATIVNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 27. JULA 2018. GODINE**

**KORRIK - JUL
2018**

Rendi i ditës

1. Seancë komemorative e Kuvendit për vdekjen e veprimtarit të shquar të çështjes nacionale, Adem Demaçi

Dnevni red

1. Komemorativna sednica Skupštine povodom smrti istaknutog aktivista nacionalnog pitanja, Adem Demaçi

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
E nderuar familje e Heroit të Kombit, Adem Demaçi,
Të nderuar mysafirë,
Zonja dhe zotërinj,
E hap seancën komemorative për vdekjen e Heroit të Kombit, z. Adem Demaçi, veprimtar i njohur për çështjen kombëtare dhe ish i burgosur politik.

Ju ftoj të ngrihemi në këmbë për intonimin e himnit kombëtar dhe himnit të Kosovës!

(Intonimi i himneve)

Në respekt dhe kujtim të figurës dhe veprës së Heroit të Kombit, Adem Demaçi, ju ftoj për një minutë heshtje.

(Një minutë heshtje)

Nderim dhe lavdi e përjetshme!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Fjalën e ka kryetari i Kuvendit, z. Veseli.

KADRI VESELI: E nderuar familje Heroit të Kombit, Adem Demaçi,
Të nderuar të pranishëm,
Zonja dhe zotërinj,
I gjithë kombi ynë është në pikëllim. E kemi humbur njërin prej njerëzve më të mëdhenj që ka dhënë kjo tokë në 100 vjetët e fundit. E kemi humbur Adem Demaçin, simbolin e gjithë Lëvizjes sonë kombëtare për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, heroin dhe frymëzimin tonë.

Dhimbja është e pafund, por aq e pafund edhe krenaria që e patëm këtë burrë të madh, të rrallë e të jashtëzakonshëm të kombit. Një patriot i pashoq.

Adem Demaçi ishte i pari ndër të parët në luftën e vështirë e plot sakrificë për çlirim kombëtar. Kur pas vitesh terrori, regjimi jugosllav po kremtonte shtypjen e plotë të rezistencës shqiptare, pikërisht në mesin e viteve të '50-ta të shekullit të kaluar, ishte Adem Demaçi që ngrehu zërin e rezistencës e të kryengritjes për liri. Dhe, nuk u ndal e nuk u dorëzua asnjëherë.

E burgosën, e izoluan, e dënuan, e ri-dënuan, 28 vjet pandërprerë. Por, nuk e thyen. Nuk e bënë për vete asnjëherë.

Adem Demaçi e kishte mposhtur frikën nga pushtuesi dhe me guximin e tij ai e mësoi një popull të tërë ta mposhtë frikën. Këtu nisi liria, sepse një popull që nuk i frikësohet pushtuesit, ai domosdo do ta fitojë lirinë.

Adem Demaçi ishte ndërgjegjja e lëvizjes sonë kombëtare për çlirimin e Kosovës. Disidenti më kokëfortë në gjithë botën komuniste. Mandela i Evropës. Disident i kalibrit të Vaslav Havel, e Leh Valensa. Përfaqësuesi më eminent i shqiptarëve të Kosovës në rezistencën evropiane kundër tiranisë komuniste. Për këtë, bota demokratike e nderoi me Çmimin Saharov. Vepra e tij shërbeu si burim frymëzimi jo vetëm për luftën tonë, për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, por edhe për ndërtimin e shtetit të ri të Kosovës, në bazë të themeleve të shëndosha, të vlerave të lirisë e demokracisë.

Adem Demaçi ishte nderi i kombit dhe i tillë do të mbetet përjetë e mot. Secili nga ne sot ndihet krenar që e patëm fatin të jetojmë në epokën e Adem Demaçit. Intelektual e veprimtar politik i nivelit evropian.

Ai kurrë nuk kërkoi asgjë për vete. Asgjë! Për të, liria e Kosovës ishte nderimi më i madh. Dhe, nëse ka një njeri që me jetën dhe veprën e tij e mishëron më së miri raportin e individit me Atdheun, siç shkon ajo thënia e famshme, emblematike – “mos pyet çfarë ka bërë Atdheu për ty, por çfarë ke bërë ti për Atdheun” - ky njeri është Adem Demaçi. Po! Një pjesë e historisë së Kosovës është historia e jetës së tij.

Faleminderit për gjithçka bërë për atdheun gjatë gjithë jetës tënde, Adem Demaçi.

Përherë do të jetosh në zemra tona. Fëmijët tanë do të rriten duke mësuar për ty. Institucionet tona do të frymëzohen nga patriotizmi yt. Kujtimi për ty do të jetojë përgjithmonë, ashtu siç do të jetojë përgjithmonë ajo së cilës ia kushtove gjithë jetën: LIRIA E KOSOVËS. Faleminderit!

KRYESUESI: E ftoj në emër të kryetarit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, z. Gramoz Ruçi, nënkryetaren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, zonjën Vaselika Hysi

VASELIKA HYSI: E dashur Xhemajlie,

I dashur Shqiptar,

E dashur Abetare, që je duke udhëtuar për të ardhur pranë babait tuaj.

Të dashur familjarë të mikut, kolegut, të luftëtarit, z. Adem Demaçi,

I nderuar president i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi,

I nderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës, z. Kadri Veseli,

I nderuar kryeministër i Kosovës, z. Ramush Haradinaj,
I nderuar kryetar i Kuvendit të Maqedonisë, z. Talat Xhaferi,
Të nderuar kolegë dhe kolege,
Të nderuar miq,

Sot të gjithë jemi të dëshpëruar dhe të pushtuar nga hidhërimi i madh. Prej ditës së djeshme, Kosova dhe shqiptarët nuk janë më si më parë. Mbetëm pa shqiptarin, patriotin, heroin, shkrimtarin, luftëtarin, dijetarin, humanistin, luftëtarin e të drejtave të njeriut, kalorësin e paqes, pa Adem Demaçin.

Sot, në emër të kryetarit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, z. Gramoz Ruçi, dhe në emër të të gjithë kolegëve të mi deputetë, sjell ngushëllimet për këtë humbje të rëndë. E humbën një njeri të madh dhe të jashtëzakonshëm. Nuk është më midis nesh luftëtari i lirisë dhe i paqes, i njohur dhe i respektuar jo vetëm në Kosovë, por në gjithë trojet shqiptare dhe kudo ku jetojnë shqiptarët anembanë botës.

Kosova e lirë humbi njërin ndër frymëzuesit dhe martirët e saj. Të gjithë ne nuk e kemi në oratorin dhe luftëtarin e të drejtave për Kosovën dhe të gjithë popullit shqiptar. Por, ndarja nga jeta e Adem Demaçit thërret për t'u bërë të gjithë më të fortë. Energjitë e tij të pashtershme, ne duhet t'i kemi inspirim të mirë.

Me forcën e Tij na mësoi ta gjejmë dhe konkretisht këtu. Me energjitë e tij të pashtershme në burg dhe jashtë saj, që buronin nga shqiptarizmi dhe patriotizmi. Në vetëmohimin e Tij për lirinë e Kosovës dhe lirinë e shqiptarëve. Në sakrificat e Tij të pashembullta në emër të demokracisë dhe përparimit. Në dhimbjen e Tij për të gjitha gratë dhe vajzat. Burrat dhe gratë. Të rinjtë dhe të rejat. Djemtë dhe vajzat e Kosovës. Dhe, të të gjithë shqiptarëve. Në aftësitë dhe në mësimet e tij të vyera për ta ndërtuar demokracinë dhe institucionet e saj në shërbim të të gjithë qytetarëve, pa dallim. Në kontributin e tij të shquar për zhvillimin e kulturës dhe të qytetërimit shqiptar. Në humanizmin, në shpirtin e sakrificës, në emër të interesave të mëdha kombëtare. Por, mbi të gjitha, në thjeshtësinë dhe në madhësinë e këtij shkrimtari të madh që vuajti dhe sakrificat sublime e ngjitën në panteonin e Lirisë.

Të qoftë i lehtë dheu i mëmëdheut, i dashur Adem Demaçi, miku ynë i shtrenjtë dhe i paharruar i të gjithë shqiptarëve, kudo ku ata jetojnë.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYETARI: Faleminderit! E ftoj kryetarin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, z. Talat Xhaferi, ta marrë fjalën në nderim të Heroit të Kombit, Adem Demaçi.

TALAT XHAFERI: I nderuar president i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi,
I nderuar kryetar i Parlamentit të Republikës së Kosovës, z. Kadri Veseli,
I nderuar kryeministër i Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj,
Të nderuar kolegë deputetë,
Shkëlqesi,
E dashur Familje Demaçi,
Të nderuar qytetarë të Kosovës,
Medie,
Zonja dhe zotërinj,

Sot jemi tubuar këtu me një shkas që na pikëlloi të gjithë ne që e kemi pasur fatin të jetojmë në të njëjtën kohë kur ka frymuar dhe ka vepruar Heroi i Kombit, simboli i rezistencës kombëtare, udhërrëfyesi dhe zëri i ndërgjegjes popullore, mbrojtësi i të drejtave dhe lirive edhe të atyre që nuk i përkasin kombit tonë, liridashësi dhe atdhetari, vizionari, shkrimtari i dalluar, i dashuri ynë, Adem Demaçi.

Nuk është lehtë që me pak fjalë të përshkruhet vepra madhështore, flijimi altruist dhe puna e palodhshme e të çmuarit Adem Demaçi, i cili nuk u përkul, nuk u thye dhe nuk u dorëzua para asnjë sfide, para asnjë vështirësie dhe dhimbjeje, edhe pse me jetëshkrimin e tij shënohen, siç edhe u përmend, plot 28 vjet të kaluara nëpër burgje dhe nën presion politik. Por, ai e kishte gjithmonë shikimin larg, gjithmonë kah ardhmëria më e ndritur për kombin, për shtetin dhe për gjeneratat e ardhshme.

Nuk u ndal kurrë së menduari për atë se si të ndërtohet një shtet i pavarur, demokratik dhe i barabartë me shtete përreth dhe më gjerë, shtetit juridik në të cilin do të sundojë e drejta për të gjithë njësoj, pa dallim me përkatësinë etnike, fetare, gjuhësore, gjinore apo klasore; shtet në të cilin nuk do të ekzistojë hakmarrja e gjakut, vëllavrasja dhe urrejtja ndaj të ndryshmit.

Vepra e të respektuarit Adem Demaçi, përveç nga institucionet vendore, ku është shpallur Hero i Kombit, është vlerësuar lart edhe nga institucionet botërore. Për shembull, Parlamenti Evropian i ka ndarë Çmimin Saharov për lirinë e të folurit, me të cilin nderohet individë dhe grupe njerëzish, të cilët jetën ia kanë përkushtuar mbrojtjes të të drejtave të njeriut dhe lirisë së të menduarit.

Ndarja e të çmuarit Adem Demaçit nga jeta është humbje e madhe për të gjithë shqiptarët, për të gjithë njerëzit liridashës dhe atdhetarë, por edhe për gjithë njerëzimin që e vlerëson lart lirinë dhe barazinë ndërmjet njerëzve anembanë botës. Largimi i Tij nga kjo botë është i hidhur për familjarët e tij të afërm, për bashkëpunëtorët e tij, për bashkëqytetarët, por edhe për të gjithë shqiptarët kudo që janë.

Qëndroni të fortë, Familje e nderuar! Qëndroni krenarë për çastet e përbashkëta që i keni pasur, sepse ndarja është vetëm ndarje fizike. Personaliteti i tij unik është i paharrueshëm dhe i pazëvendësueshëm dhe vepra e tij madhështore nuk do të harrohet kurrë. Do të jetë trashëgimi dhe porosi që do ta ruajmë, vlerësojmë, çmojmë dhe nderojmë, por edhe do ta vazhdojmë të gjithë ne që në mënyra të ndryshme, nga pozitat që i kemi, në periudha të caktuara, do ta kemi ndikimin në zhvillimet dhe rrjedhat shoqërore në vendet tona.

Prehu në paqe, i dashur Adem! Lavdi përgjithmonë! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar të pranishëm,

Me këtë e mbyllim seancën komemorative dhe do të vazhdojmë me homazhe pranë arkivolit të Heroit të Kombit, Adem Demaçi. E kisha ftuar në rend të parë familjen, që t'i fillojë homazhet, pastaj do të kalojnë përfaqësuesit e institucioneve, Presidenti, kryetari i Kuvendit, Kryeministri, deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Qeveria, grupet parlamentare, në mënyrë që pastaj të hapet edhe për qytetarë.

Urdhëro, Shqiptar Demaçi!

SHQIPTAR DEMAÇI: Të nderuar mysafirë që keni ardhur për nderimin e figurës së Bacës Adem, babës tim dhe tonë, ju falënderoj për këtë organizim.

Desha të shtoj që Baca Adem ka vdekur i qetë, dhe gjithmonë i qetë do të jetë. Por, edhe më i qetë do të jetë në një Kosovë të organizuar. Kjo ka qenë dëshira e Tij. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit Shqiptar Adem Demaçi, djali i Heroit të Kombit.

Atëherë, familja, nëse ka mundësi Shqiptar, së bashku me nënën, me bashkëshorten dhe me motrën e me nipat të kaloni në homazhe, pastaj do të vazhdojmë sipas rendit. Pas krerëve të shtetit, janë mysafirët, kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, dhe zonja nënkryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*